



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI**

*Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, Tel-Fax:042 232491*

Nr. 750/24 Prot

Tiranë, më 28.12.2016

### **V E N D I M**

**Nr.167, Datë 28.12.2016**

**PËR  
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR  
NË DREJTORINË RAJONALE TATIMORE KORÇË “MBI ZBATIMIN E  
LEGJISLACIONIT TATIMOR NË PROCESIN E REALIZIMIT TË TË  
ARDHURAVE TATIMORE, KONTRIBUTET E SIGURIMEVE  
SHOQËRORE E SHËNDETËSORE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit të paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitëtin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeadituesi i Departamentit të Auditimit të mësipërm, Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 15, 25, 26 dhe 30 të ligjit nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

### **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore” për periudhën nga 01.01.2014 – 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të ardhurave për periudhën 2014 dhe 2015 rezultoi se, të ardhurat tatimore në total për vitin 2014, janë realizuar në masën 93.54 % ose nga 4,583,000 mijë lekë që ishte plani, janë arkëtuar 4,286,800 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute në shumën 296,200 mijë lekë, nga të cilat 120,653 mijë lekë nga të ardhurat tatimore dhe 175,547 mijë lekë nga kontributet e sigurimeve shoqërore. Për vitin 2015, të ardhurat tatimore në total janë realizuar në masën 95,15% ose nga 4,451,000 mijë lekë që ishte plani, u arkëtuan 4,235,059 mijë lekë, me një mosrealizim në vlerë absolute në shumën 215,941 mijë lekë, nga të cilat 125,393 mijë lekë nga të ardhurat tatimore dhe 90,540 mijë lekë nga kontributet e sigurimeve shoqërore.

Për të dy vitet e audituara DRT Korçë rezulton me mosrealizim të planit të të ardhurave, situatë për të cilën nuk është bërë analizë e detajuar e faktorëve të mosrealizimit të planit, dhe nuk është vepruar për të marrë masat e nevojshme për realizimin e të ardhurave buxhetore. *(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Nga DRT Korçë të bëhet analizë e detajuar e aktivitetit operacional në drejtim të realizimit të ardhurave tatimore, për të identifikuar risqet e lidhura me mosrealizimin e tyre dhe për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e treguesve fiskalë.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Borxhit, u konstatua se për vitin 2014 detyrimet e pambledhura në fund të vitit janë në vlerën 2,645,621 mijë lekë të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë rritur në total për shumën 544,406 mijë lekë ose në masën 20%. Në totalin e borxhit për vitin 2014 detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 513,390 mijë lekë ose 19.5 % e të gjithë borxhit.

Për vitin 2015 detyrimet e pambledhura në fund të vitit janë në vlerën 2,588,820 mijë lekë të cilat krahasuar me vitin paraardhës janë ulur për shumën 56,801 mijë lekë ose në masën 2.2%. Në totalin e borxhit për vitin 2015 detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore janë në shumën 490,308 mijë lekë ose 19% e të gjithë borxhit. Nga marrja e masa shtrënguese në shumën 4,978,448 mijë lekë janë arkëtuar 85,628 mijë lekë ose vetëm 1,72%. Efektiviteti i masave shtrënguese paraqitet shumë i ulët, si në shumën e arkëtuar edhe në numrin e rasteve mbi të cilat evidentohet veprim i strukturave të kësaj drejtorie. Nga auditimi u konstatua se për debitorët nuk janë vendosur masat shtrënguese "Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë", "Njoftim Transferim Detyrimi Palës së Tretë", "Njoftim për Transferimin e Detyrimit të Ortakut, Aksionerit, Administratorit", nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920/2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", nenet 94-98 dhe udhëzimit në zbatim të tij.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 102-113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Mbledhjes së Borxhit, sipas debitorëve të evidentuar në regjistrin e borxhit, të vazhdojë marrjen e masave shtrënguese, për “Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë”, “Njoftim Transferim Detyrimi Palës së Tretë”, “Njoftim për Transferimin e Detyrimit të Ortakut, Aksionerit, Administratorit”.

**Në vijimësi**

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga analiza për respektimin afateve të rimbursimit u evidentua se ka një shpërndarje jo normale të ditëve nga kërkesa në dërgimin e kontrollit, nga kontrolli në përfundimin e raportit të kontrollit dhe nga raporti në pagesën apo kreditimin e TVSH-së të tatimpaguesit. Në shumë raste ka vonesa të dërgimit të kontrollit apo evadimit të raportit të kontrollit duke krijuar një mjedis me risk për realizimin e procesit të rimbursimit në kohë.

Nga auditimi i Raport Kontrolleve për saktësimin e TVSH-së së rimbursueshme, lidhur me kërkesat për rimbursimin e TVSH-së ka rezultuar se nga inspektorët e kontrollit operacional kanë bërë raporte thuajse formale duke mos bërë zbërthime të plota të normativave të përdorimit të mallrave e materialeve të blera për të cilat është kërkuar rimbursim dhe sa këto blerje i kanë shërbyer aktivitetit e shitjeve, por është mjaftuar me konstatimin se blerjet janë me dokumente të rregullta ligjore. Veprimet mësipërme bien në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor TP 4.3 “Blerjet” ku përcaktohet se: “*Kryhet kontroll i zgjeruar për blerjet për t’u siguruar se ato janë për qëllime të aktivitetit ekonomik dhe për nevojat e tij, që kërkesat për rimbursim për blerje me TVSH nuk janë më të larta, dhe tatimi i zbritshëm për blerjet nuk është fshehur ose keqpërshkrim si shpenzime për të rakorduar fshehjet e shitjeve të bëra*” dhe TP 4.4. Kontrolle specifike për TVSH ku përcaktohet: *Nëse tatimpaguesi merret me eksportin e mallrave, mallrat për eksport me tarifë zero, duhen shoqëruar me një certifikatë hyrje nga pika doganore e një vendi tjetër që të provojë daljen e mallit nga Shqipëria.* (Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 27-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Në miratimin e kërkesave për rimbursimin e TVSH-së të kryhet një analizë e detajuar për blerjet me TVSH të kreditueshme, duke u siguruar se ato janë për qëllime të aktivitetit ekonomik dhe për nevojat e tij, me qëllimin që kërkesat për rimbursim për blerje me TVSH të jenë reale.

**Në vijimësi**

### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i praktikës së rimbursimit të TVSH-së për tatimpaguesin “██████████ me NIPT ██████████, ka rezultuar se në kërkesën për rimbursim në vlerën 5,591,741 lekë koha nga kontrolli në raport është vetën 23 ditë dhe për kërkesën për rimbursim në vlerën 8,351,959 është 69 ditë, të dyja kohë ndjeshëm më pak se koha e hartimit të subjekteve të tjera mbi 100 ditë.

Nga kontrolli tatimor nuk është llogaritur saktë kreditimi TVSH-së në shumën 7,170,427 lekë për harxhimin e karburantit për transportin e mallit dhe përpunimin e tij, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave Nr. 17, datë 13.05.2008 “Për tatimin

mbi vlerën e shtuar” pika 19.4 dhe 19.5 “Raste të veçanta për trajtimin e së drejtës për kreditimin e TVSH-së”, për të cilën ulet TVSH e kreditueshme në shumën 7,170,427 lekë. Nga ana tjetër, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, Neni 114 pika 1 dhe 2 “Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit”, konsiderohet shumë e papaguar e detyrimit tatimor, për të cilën në rastin e një rivlerësimi tatimor, nga inspektori duhet të ishte vendosur edhe penalteti në shumën 1,570,324 lekë.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 42-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, Drejtoria e Kontrollit Operacional për subjektin “████” me NIPT █████ të kërkojë rikontroll referuar nenit 85 pika “c “ të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, për parregullsitë e konstatuara nga grupi i auditimit.

**4.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe strukturat përgjegjëse në këtë drejtori të verifikojnë miratimin e rimbursimit të TVSH-së për këtë tatimpagues si dhe të ndjekin procedurën ligjore për veprime në mospërputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” neni 75/1 “Rimbursimi i TVSH-së dhe kompensimi i detyrimeve tatimore” si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të tij.

**Deri më 30.06.2017**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se në lidhje me procedurat e ndjekura për nisjen e procedurës së falimentimit nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat në RSH", i ndryshuar, neni 104 "Fillimi i procedurave të falimentimit", në lidhje me fillimin e procedurës së falimentimit. Nga krahasimi subjekteve me humbje për periudhën e vitit 2013 me subjektet e kontrolluara gjatë vitit 2014, rezultoi se për vitin 2013 kanë dorëzuar Pasqyrat Financiare dhe Deklaratën e Tatimit mbi Fitimin në vitin 2014, me humbje 143 subjekte, të cilët kanë deklaruar humbje ushtrimore 283,971 mijë lekë. Gjatë vitit ushtrimor, nga 221 subjekte të kontrolluara vetëm 31 raste janë subjekte me humbje. Këto subjekte kanë deklaruar një humbje në shumën 105,323 mijë lekë vlerë që përbën vetëm 37% të humbjes ushtrimore të deklaruar.

Për vitin 2014 kanë dorëzuar Pasqyrat Financiare dhe Deklaratën e Tatimit mbi Fitimin në vitin 2015, me humbje 138 subjekte, të cilat kanë deklaruar humbje ushtrimore 270,249 mijë lekë. Gjatë vitit ushtrimor, nga 59 subjekte të kontrolluara, 4 raste janë subjekte me humbje. Këto subjekte kanë deklaruar një humbje në shumën 1,322 mijë lekë që përbën vetëm 5% të humbjes ushtrimore.

(Trajtuar më hollësisht në faqet nr.49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit të evidentojë, shqyrtojë dhe dërgoj për kontroll subjektet që kanë deklaruar një nivel humbje të madhe për vitin ushtrimor, duke kërkuar një mbulim mbi 50% të humbjeve të deklaruara.

Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për të gjitha rastet e përcaktuara në kërkesat e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat në RSH", i ndryshuar, neni 104 "Fillimi i procedurave të falimentimit".

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Operacional rezultoi se për periudhën 2014 janë realizuar 221 kontrole me zbulim në total në shumën 111,972 mijë lekë, me forcë zbuluese për kontroll në shumën 507 mijë lekë dhe forcë zbuluese për inspektor në shumën 5,332 mijë lekë. Për periudhën 2015 janë realizuar 59 kontrole me zbulim në total në shumën 23,098 mijë lekë, me forcë zbuluese për kontroll në shumën 391.5 mijë lekë dhe forca zbuluese për inspektor në shumën 1,777 mijë lekë. Në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 kemi ulje me 162 raste të kontroleve të realizuara, ndërkohë që treguesi i zbulueshmërisë ka rënie me 88,874 mijë lekë ose është 21% më i ulët se viti paraardhës. Të dhënat reflektojnë rënie të zbulueshmërisë për kontroll në shumën 115 mijë lekë dhe rënie të zbulueshmërisë për inspektor në shumën 3,555 mijë lekë.

Nga auditimi i veprimtarisë u konstatua se në dosjet e kontrollit mungonte një analizë e detajuar e shpenzimeve të paraqitura në PASH, ku si objekt i kontrollit është tatim fitimi, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8438 datë 12.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” dhe me Manualin e Kontrollit Tatimor.

Gjithashtu, u konstatua se në raportet e kontrollit të subjekteve në analizën e importeve mungojnë të dhëna për referencat doganore për të mundësuar një analizë të shpenzimeve të deklaruar në FDP me shpenzimet në bilanc.

Nga auditimi është konstatuar se në Raportin Përfundimtar të Kontrollit Tatimor, nuk përshkruhen gjetjet dhe problemet e konstatuara, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 84 pika 2 dhe Udhëzimi Ministrit të Financave Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, pika 84.2, sipas të cilit citojmë: “ *Raporti përfundimtar i kontrollit duhet të përshkruajë detajet e veprimeve të kryera gjatë kontrollit, deklaratat, dokumentet, librat, regjistrat dhe regjistrimet e kontrolluara, të dhënat e shfrytëzuara gjatë kontrollit dhe burimet e tyre, mënyrat e ushtrimit të kontrollit, gjetjet me kryesore të tij, problemet e dala, rezultatet e kontrollit, shkeljet e kryera nga personi i tatueshëm me argumentimin përkatës, shumën e vlerësimit tatimor të propozuar dhe referencat përkatëse ligjore.*

*(Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 52-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Nga Drejtori e Kontrollit Tatimor të merret në analizë performanca e ulët e kontroleve të realizuar dhe fokusimi në kontrole mbi bazë risku në të ardhmen, me qëllim rritjen e efikasitetit të strukturave të kësaj drejtori në luftën ndaj evazionit fiskal.

**6.2. Rekomandimi:** Në raportin e kontrollit, të analizohet dhe të pasqyrohet analizë e detajuar e TVSH-së së importeve duke pasqyruar veçmas TVSH-në për faturën e origjinës dhe referencën në doganë, për të mundësuar një kontroll sa më real të situatës financiare të subjekteve objekt kontrolli.

**6.3. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Kontrollit Operacional në Raportin Përfundimtar të Kontrollit të përshkruhen detajet e veprimeve të kryera gjatë kontrollit, gjetjet, problemet e evidentuara dhe rezultatet e kontrollit tatimor.

**Në vijimësi**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Nisur nga gjetjet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, mbi mospërputhjet me legjislacionin tatimor, udhëzimet dhe VKM-të e fushës, Manualin e Kontrollit Tatimor dhe Rregullores së Brendshme, me parregullsi që shtrihen në fushën e përpilimit të raporteve, procedurave të evadimit të njoftim vlerësimeve, marrëdhëniet me tatimpaguesin dhe institucionet e prore dhe paralele, me veprimet dhe mos veprimet e saj, Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë, i ka sjellë buxhetit të shtetit një nivel mungese të ardhurash në masën **75,884,889 lekë**, për të cilën kanë përgjegjësi personat konkretë të përmendur në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Operacional nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, me ligjet specifike tatimore që përcaktojnë detyrimin tatimor si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në zbatim të tyre, duke sjellë vetëm nga kontrolli tatimor për periudhën 2014-2015, një shmangie në shumën **46,237,771 lekë** për 19 subjekte, *(Trajtuar në faqet 42-47 dhe 52-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 3.1 bashkëngjitur).*

**1.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 20 subjekte **në shumën 46,237,771 lekë**.

**Deri më 30.06.2017**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, neni 33 “Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” germa “ë” dhe neni 35 “Mbajtja e tatimit në burim, regjistrimi, deklarimi”, Udhëzimi nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, pika 2.3.6 dhe Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Neni 117 në lidhje me mbledhjen e tatimit në burim mbi të ardhurat nga qeraja për llogari të organeve tatimore, për 187 subjekte, me një efekt në shumën **4,557,603 lekë**.

*(Trajtuar në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.1 bashkëngjitur).*

**2.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 187 subjekte **në shumën 4,557,603 lekë**.

**Deri më 31.03.2017**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 33/1 dhe 33/2, në lidhje me mos dorëzimin brenda afatit ligjor, të vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimin e fitimit të rezultatit financiar të vitit ushtrimor 2013, për 6 subjekte me një efekt **në shumën 1,020,000 lekë.**

*(Trajtuar në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.1 bashkëngjitur).*

**3.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 6 subjekte me një efekt **në shumën 1,020,000 lekë.**

**Deri më 31.03.2017**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, neni 33/1 “*Depozitimi i vendimit pas miratimit të rezultatit vjetor dhe destinacionit të fitimit*” në të cilin në pikën 1 cilësohet se: “*Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi*” dhe pika 3 ku cilësohet “*Personi juridik duhet të deklarojë dhe të paguajë për llogari të administratës tatimore tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, jo më vonë se data 20 gusht e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit*”, në lidhje me pagesën e tatimit mbi dividendin e shpërndarë mbas datës 20 Gusht të vitit 2014 dhe vendimet e asamblesë së ortakëve për këto pagesa, të cilat nuk janë dorëzuar në DRT Korçë, as në QKR, për 10 raste (subjekte), me një efekt **në shumën 12,734,515 lekë.**

*(Trajtuar në faqet 21-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.2 bashkëngjitur).*

**4.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 10 raste (subjekte), me një efekt **në shumën 12,734,515 lekë.**

**Deri më 31.03.2017**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, nenit 126 “*Mosdhënia e informacionit*” ku citohet: “*Refuzimi për dhënie e informacionit të kërkuar nga administrata tatimore*”, për

të cilat në përputhje me dispozitat e këtij ligji, duhet të vendoset penaltitet 10 000-50 000 lekë për çdo shkelje, për mosdhënie informacioni për pranimin e pasqyrave financiare të vitit 2013 dhe pasqyrave financiare të vitit 2014, mungesa e të cilave nuk është kërkuar nga inspektorët, për 206 raste, me një efekt **në shumën 10,300,000** lekë.

(Trajtuar në faqet 18-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, si dhe në Aneksin nr. 2.2.2 bashkëngjitur).

**5.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 206 raste me një efekt **në shumën 10,300,000** lekë.

**Deri më 31.03.2017**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se nga inspektorët e Sektorit të Verifikimit në Terren nuk është vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” neni 122 pika 1, germa a, b në lidhje me vendosjen e penaltitetit për mosinstalim të pajisjes fiskale dhe për mos lëshimin e kuponit tatimor, për 12 raste (subjekte) me një efekt **në shumën 1,035,000** lekë.

(Trajtuar në faqet 92-102 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Kërkojmë që të merren të gjitha masat për të kryer veprimet që do të sigurojnë mbledhjen e të ardhurave nga subjektet që kanë përfituar apo kanë shmangur pagesën e detyrimeve, për 12 raste (subjekte) me një efekt **në shumën 1,035,000** lekë.

**Deri më 30.06.2017**

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme, sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

*Neni 58 germa “c-ç”, nga “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” deri në “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësit civil, si më poshtë:*

1. **Z. J. S.** , Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit
2. **Znj. O. Ç.** , Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
3. **Znj. I. P.** , Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
4. **Znj. M. D.** , Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
5. **Znj. O. Ç.** , Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
6. **Znj. R. S.** , Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor
7. **Z. V. V.** , Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

**8. Z. A. H. ,** Inspektor në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

a. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr. 24 datë 02.09.2008.*

b. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

*(Trajtuar në faqet 18-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Menjëherë**

**Neni 58, germa (c) “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për nëpunësit civilë si më poshtë:**

**9. Z. K. B. ,** Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**10.Z. K. Xh. ,** Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**11.Z. J. A. ,** Inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008“Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr.17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit, *(Trajtuar në faqet 51-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12. Z. V. P. ,** Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren

**13. Z. G. K. ,** Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Terren

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008“Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit në Terren, *(Trajtuar në faqet 89-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**Menjëherë**

***Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, për punonjësit e larguar nga sistemi tatimor, sipas Neni 58 germa “ç”, janë në nivelin e masës “Largim nga shërbimi civil”, për të cilët, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, të njoftojë Departamentin e Administratës Publike si dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për rekomandimin e KLSH-së për punonjësit e mëposhtëm:***

**14. Z. A. B. , ish-** Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

**15. Z. A. D. , ish-** Inspektore në Drejtorinë e Vlerësimit Tatimor

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608, datë 04.10.2010 për mos përmbushjen e detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- a. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008.*
- b. *Jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.*

**16. Znj. M. K. ,** ish- Drejtore në Drejtorinë Rajonale Korçë dhe Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**17. Z. G. K. ,** ish Drejtor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimordhe ish Përgjegjës në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor.

**18. Znj. V. A. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**19. Z. P. T. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**20. Z. S. K. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**21. Z. H. S. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**22. Z. S. T. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**23. Z. A. F. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

**24. Z. J. D. ,** ish inspektor në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor

Për veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008“Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, udhëzimit nr. 24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, datë 28.12.1998, ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në” me ndryshime, udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, si dhe kërkesave të Manualit të Kontrollit, (*Trajtuar në faqet 51-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

## **Menjëherë**

*2. Nga analiza e të metave dhe mangësive të konstatuara dhe të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për punonjësit, z. Gj. M. , z. Sh. Xh. , z. L. B. , znj. M. H. , z. B. K. , z. A. M. , znj. Zh. M. , znj. L. K. , znj. O. T. , z. M. M. , z. A. L. , z. E. Sh. është menduar të mos rekomandohet masë disiplinore, pasi mospërmbushja e detyrave prej tyre nuk është në nivelin e përgjegjësisë për fillimin e ecurisë disiplinore.*

## **D. TË TJERA**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Korçë, rezultoi se, në procesin realizimit të rimbursimit të tatimpaguesve, proces që fillon nga kërkesa për rimbursim, fillimin e kontrollit tatimor, përfundimin e kontrollit, deri në kryerjen e rimbursimit të TVSH-së, ka një shpërndarje jo normale të ditëve për realizimin e procedurës së rimbursimit, duke krijuar një mjedis me risk për realizimin e procesit të rimbursimit. Nga auditimi i Raportit Kontrollive, lidhur me kërkesat për rimbursimin e TVSH-së ka rezultuar se, inspektorët e kontrollit operacional kanë bërë raporte thuajse formale duke

mos bërë zërthime të plota të normativave të përdorimit të mallrave e materialeve të blera dhe se sa këto blerje i kanë shërbyer shitjeve, parregullsi të cilat ndikojnë në llogaritjen e TVSH-së së rimbursueshme.

Për sa më sipër, në një afat të përshtatshëm, KLSH do të zhvillojë auditim tematik për procesin e miratimit dhe rimbursimit të TVSH-së.

Me ndjekjen dhe zbatimin e masave të rekomanduara me këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**